



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivered	03-08 2022	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prlieg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/PH/AC	4514/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.556/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.556/2022 të datës 22.06.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avoka me adresë në Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokolli 589 të datës 30.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.556/2022 e datës 22.06.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 589 i datës 30.05.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës si dhe Akt Emërimi AE.Nr.009/2022 i datës 30.05.2022 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e vendimit siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datë 22.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3614/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 589 të datës 30.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave që rregullojnë formën dhe elementet e

detyrueshëm të aktit administrativ, vendimi i kundërshtuar me ankesë është tendencioz dhe diskriminues dhe cenimit të parimeve të përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa me datë 29.06.2022, Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me këtë çështje juridikë-administrative.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 3614/20222 të datës 22.06.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit .589 të datës 30.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Autorizimin e datës 02.12.2021 dhe 22.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.06.2022; Akt Emërimit AE.Nr.009/2022 i datës 30.05.2022; Njoftimin mbi deklarinimin e statusit të zyrtarëve publikë i datës 16.06.2021; Emailin e datës 05.07.2022 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ dhe Vendimin A.nr.289/2022 i datës 11.05.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **SEPSE :**

Nga administrimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji ka gjetur se me Vendimin A.nr.289/2022 të datës 11.05.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 28.03.2022, duke e shfuqizuar Vendimin me Nr.0275 të datës 07.03.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe ka obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës që t'i lëshojë ankuesit akt emërimit të përhershëm (pa afat të caktuar) në Shërbimin Korrektues, ndërsa Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues në zbatim të vendimit të këtij vendimi më vendimin me numër protokollit 589 të datës 30.05.2022, ka sistemuar ankuesin në pozitën *Udhëheqës i Njësisë për Transportimin e të Burgosurve* në Qendrën Korrektuese në Dubravë, duke i lëshuar edhe Akt Emërimit AE.Nr.009/2022 për të njëjtën pozitë.

Ankuesi i pakënaqur me këtë sistemim, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ sipas nenit 52.1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 48 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe së vendimi i kundërshtuar me ankesë është tendencioz dhe diskriminues dhe cenon parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë. Me tej shton se pozita në të cilën është sistemuar është 178 kilometra larg nga vendbanimi i tij duke pretenduar që ka pozita të lira në kuadër të Shërbimit Korrektues e të cilat i përshtaten përvojës, aftësive si dhe vendbanimit të ankuesit Propozon që të aprovohet si e bazuar ankesa, të shfuqizohet Vendimi me numër protokollit 589 të datës 30.05.2022, dhe të obligohet Shërbimi Korrektues që ankuesin të sistemojë në një pozitë që i përgjigjet përvojës dhe përgatitjes profesionale dhe në një lokacion me afër vendbanimit të tij sipas kontratës se punës se datës 18.03.2017.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore së vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk ka elementet e aktit administrativ, Kolegji ka analizuar Vendimin me numër protokollit 589 të datës 30.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës lidhur



me sistemimin e ankuesit në pozitën e Udhëheqësit të Njësisë për Transportimin e të Burgosurve në Qendrën Korrektuese në Dubravë, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se vendimi i atakuar nuk përmban ndonjë sqarim lidhur me faktet vendimtare që janë marrë për bazë për rastin e sistemimit të ankuesit, përkatësisht sipas vlerësimit të Kolegjit me rastin e sistemimit të ankuesit nuk janë marrë parasysh përvoja disa vjeçare e ankuesit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përgatitja arsimore, aftësitë profesionale si dhe largësia e vendit të punës me vendbanimin e ankuesit. Po ashtu, mbi këtë bazë ankimore, Kolegji verën së vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk përmban udhëzime mbi të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike, andaj, nisur nga këto rrethana rezultojnë se një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, konsiderohet akt i paligjshëm sipas nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e si rrjedhojë, Kolegji konstaton së është i bazuar pretendimi ankimor theksuar si me sipër.

Për vendosje meritore, Kolegji i Këshillit ju referua edhe nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik më të cilin është përcaktuar se: *1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë, andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke marrë parasysh të gjeturat si me lartë, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e rishqyrtimit të kësaj çështje juridike është i obliguar që të marrë për bazë konstatimet sipas këtij vendimi, të eliminojë shkeljet e konstatuar dhe të veprojë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, rrjedhimisht mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson që me rastin e sistemimit të ankuesit në mënyrë analoge duhet të zbatohen dispozitat e nenit 52 të ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Siç u tha me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me A.nr.556/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.